




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO				
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT				
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE				
ANTI-CORRUPTION AGENCY				
Dep.	Dep.	Dep.	DPKI	Nr Prot.
Nr. I faq	Broj stranica	Nr. pages	02	Br Prot.
				Prot No
				06-1478/20
				Date
				Datum
				Date
				13-07-2020
PRISHTINE				



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.07.2020, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbylljet rasti me nr. AKK-DPKI-06-1178/20, për zyrtarin e lartë z. Hazir Haziri, Prodekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

- I. Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia) ka shqyrtau rastin për konflikt të interesit me numër protokollit *AKK-DPKI-06-1178/20*, lidhur me zyrtarin e lartë z. Hazir Haziri, Prodekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar rastin e konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Hazir Haziri, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Prodekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, i njëjti ushtronte funksionin e Drejtorit Ekzekutiv dhe Përfaqësuesit të Autorizuar në Organizatën jo-qeveritare “Global Acting Network”. Përmes shkresës zyrtare nr. DPKI-06-515/20, Agjencia fillimisht ka kërkuar nga Departamenti për OJQ, Ministria e Administratës Publike, verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni dhe nga përgjigja zyrtare (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-776/20), rezulton se zyrtari i lartë z. Hazir Haziri është Drejtor Ekzekutiv dhe Person i Autorizuar në OJQ-në në fjalë.



Me rastin e konfirmimit të informacionit të mësipërm, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06-1178/20 e ka njoftuar zyrtarin e lartë z. Hazir Haziri për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese, zyrtari i lartë ka kontaktuar Agjencinë e cila e ka njoftuar atë gjërësisht lidhur me faktin se, gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj funksion drejtues as të jetë Përfaqësues i Autorizuar në OJQ, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, parografi 1, të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, ku thuhet se:

*“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.*

si dhe nenin 14 parografi 1, i cili përcakton se:

*“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Hazir Haziri është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëherëshme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar njoftimin (shkresa zyrtare DPKI-06/1451/20), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Hazir Haziri ka dhënë dorëheqje nga funksioni drejtues në Organizatën joqeveritare “Global Acting Network” si dhe i njëjti nuk figuron më të jetë as Person i Autorizuar në OJQ-në në fjalë.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Hazir Haziri, Prodekan i Fakultetit të Arteve, Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, janë krijuar rrëthana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësish konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë. Prandaj, në bazë të asaj që u tha më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**II. Në mbështetje të nenit 18, parografi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrëthana të reja.**

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Shaip Havollî<sup>\*</sup>  
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

